



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE**

Numri i Ceshtjes : 31155-04393-80-2020      Data e Regjistrimit : 08/10/2020  
Numri i Vendimit: 80-2021-750                      Data e Vendimit : 17/03/2021

**VENDIM**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

**GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:**

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 17/03/2021mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites Shoqeria Tregtare "{...}" sh.p.k" I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale

Objekti:Shfuqizim i Vendimit nr 833/11 date 25.10.2017 nxjerre nga Bordi I Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme e Pronesise Industriale dhe pranimin e regjistrimit te e markes "{...}" me nr aplikimi AL/T/2016/833.

Baza Ligjore:Ligji 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale; Ligj nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarreshjeve Administrative.

Ne perfundim te hetimit gjyqesor te geshtjes, te zhvilluar ne prani te perfaqesuesit te te paditures Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, ne mungese te paditeses shoqerise "{...}" sh.p.k, te pales se paditur shoqerise "{...}", Gjykata, pasi e degjoi perfaqesuesin e pales se paditur prezent i cili perfundimisht kerkoi rrezimin e kerkese padise si e pabazuar ne ligj dhe ne prova, si dhe analizoi provat e paraqitura nga palet dhe bisedoi geshtjen ne teresi,

VEREN :

Veren:

Paditesi shoqeria "{...}" sh.p.k ka paraqitur me date 01.12.2017 perpara Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane nje kerkese padi me pale te paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, person i trete shoqerise "{...}" dhe objekt: "Shfuqizimin e vendimit nr. 833/11, date 25.10.2017 nxjerre nga Bordi i Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme e Pronesise Industriale dhe pranimin e regjistrimit te e markes "{...}" me nr. aplikimi AL/T/2016/833".

Me vendimin 1500(80-2018-1530), date 23.04.2018 Gjykata Administrative Shkalles se Pare Tirane ka vendosur pranimin e pjesshem te padise. Mbi ankimin e paleve, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin 575, date 10.06.2020, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e geshtjes per rigjykim ne te njejten gjykate, me trup tjetere gjykues.

Gjykata, bazuar ne nenin 36 te Kodit te Procedures Civile, konstatoi kryesisht se kjo geshtje ben pjese ne juridiksionin gjyqesor dhe bazuar ne nenet 7, 10/1 dhe 11/2 te ligjit nr. 49/ 2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane eshte kompetente nga pikepamja lendore, funksionale dhe tokesore per shqyrtimin gjyqesor te saj. Bazuar ne parashikimet e nenit 12/1 te ligjit nr. 49/ 2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar, geshtja u mor ne shqyrtim nga trup gjykues i perbere nga nje gjyqtar.

Po keshtu, bazuar ne parashikimet e nenit 79/a te K.Pr.Civile, kerkese padia dhe aktet ju njoftuan dhe Avokatures se Shtetit Zyra Vendore Tirane, e cila, me shkrese deklaroi mospjesemarrjen, duke ia deleguar te drejten perfaqesimit organit publik.

Gjate veprimeve pergatitore, ne zbatim te detyres se lene nga Gjykata Administrative e Apelit ne vendimin nr. 575, date 10.06.2020 , perfaqesuesja e pales paditese paraqiti kerkese me shkrim dhe kerkoi te heqe dore nga thirrja e shoqerise "{...}" ne cilesine personit te trete dhe bazuar ne nenin 161/c te K.Pr.Civile kerkoi qe kjo shoqeri te thirret ne cilesine e pales se paditur.

Po keshtu, gjate veprimeve pergatitore, me kerkese te perfaqesuesit te paditesit, bazuar ne nenin 185 te K.Pr.Civile, u saktesua objekti i padise, e konkretisht: "Konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit vendimit nr. 833/11, date 25.10.2017 nxjerre nga Bordi i Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme e Pronesise Industriale dhe pranimin e regjistrimit te e markes "{...}" me nr. aplikimi AL/T/2016/833".

Me pas hetimi gjyqesor vijoi e u mbyll, mes paleve, sipas objektit dhe bazes ligjore cituar ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Nga hetimi gjyqesor rezultoi se:

Shoqeria "{...}" sh.p.k eshte person juridik i se drejtes shqiptare, i pajisur me Nipt K69006230F dhe ka per objekt veprimtarie "Tregti me pakice e librave dhe gazetave, mallit prej letre etj.", fakt i provuar nga te dhenat e ekstraktit te regjistrimit tregtar, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit. Shoqeria "{...}" sh.p.k, ka depozituar prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale kerkesen me nr. AL/T-2016/833 per regjistrimin e markes "{...}". Kjo marke eshte depozituar per regjistrim ne klasen 16 te klasifikimit te Nices per mallrat si vijon: "Letra dhe kartona, dokumenta te ndryshme te printuara, lidhje materialesh ne forme libri, printime fotografish, printime shkrimesh, material artistike, furga per piktura, makina shkrimi ne kushtet e zyres (perveg mobilieve) materiale mesimore dhe te mesimdhenies (perveg aparateve), material plastike per paketim, printera te ndryshem, blloqe te ndryshem". Bashkelidhur aplikimit ka paraqitur dhe dokumentacionin e kerkuar. Shoqeria "{...}", me adrese POLJE 9, SI-6310 Izola, Slovenia, nepermjet perfaqesuesit me autorizim z. {...} ka paraqitur kundershkrimin e saj per regjistrimin e kesaj marke. Shoqeria

paditese eshte njoftuar te paraqese pretendimet e saj ne lidhje me kete kundershtrim . Ne perfundim te procedurave administrative Bordi i Apelimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, me vendimin nr. 833/11, date 25.10.2017 ka vendosur: *"Pranimin e kundershtrimit ndaj markes me nr. AI/T/2016/833 per marken "{...}" . Refuzimin e regjistrimit te aplikimit me nr. AI/T/2016/33 per marken "{...}" .* Paditesi, duke mos qene dakord me kete akt, i eshte drejtuar gjykates me kerkese padine objekt gjykimi.

Gjate gjykimit perfaqesuesja e paditesit parashtrroi keto pretendime:

Vendimi nr. 833/11, date 25.10.2017, nxjerre nga Bordi i Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Intelektuale eshte nje akt absolutisht i pavlefshem, referuar nenit 108 te Kodit te Procedurave Administrative, sepse eshte nxjerre ne shkelje te ligjit dhe te procedurave ligjore te percaktuara. Referuar te gjithe dokumentacionit ligjor te sjelle ne kete proces, rezulton e provuar se subjekti "{...}", eshte nje subjekt per te cilin DPPI nuk disponon asnje dokument ligjor qe te vertetoje statusin e tij juridik. Pala e paditur nuk ka asnje dokument zyrtar qe te tregoje te dhena per "{...}", per menyren e regjistrimit te kesaj shoqerie, numrin unik te identifikimit (NUIS), emrin e administratorit/ortakut/aksionerit, vendin ku ushtron aktivitetin e saj tregtar kjo shoqeri apo gdo dokument tjeter ligjor. E vetmja e dhene qe disponon pala e paditur eshte kundershtrimi per regjistrimin e markes "{...}" me nr. Aplikimi AL/T/2016/833, i bere nga Av. {...}. Sipas Vendimit te Bordit rezulton se kundershguesi, per marken nderkombetare IR 1030845 "{...}" ( fjale dhe figure) pala e trete ne kete proces legjitimohet per te paraqitur kerkesen per kundershtrim pasi gezon nje te drejte te meparshme, te cilen e ka fituar nepermjet regjistrimit te markes kundershguese, pra marka kundershguese gezon statusin e markes se meparshme. Referuar detyrimeve procedurale te parashikuara ne piken 1 te nenit 35 te Ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykateve administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" pala e paditur me provat e sjella ne proces, nuk mundi te provonte ligjshmerine e aktit administrative te nxjerre. Referuar provave te sjella ne kete proces nuk ka asnje te dhene per te vertetuar menyren e regjistrimit te markes kundershguese. Por nese do ti referohemi te gjithe legjislacionit qe rregullon si regjistrimin fillestar te markes, por edhe atij nderkombetar, rezulton se ne secilin nga rastet qe mund te supozojme se eshte kryer nga ana e te paditurit regjistrimi dhe marrja ne shqyrtim e kundershtrimit eshte kryer ne kundershtrim flagrant me ligjin. Refuzimi i regjistrimit te markes eshte bere ne kundershtrim me parashikimet e ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale", neni 145, vendimit nr. 1706, date 29.12.2008 i ndryshuar dhe dy marreshjeve ku Republika e Shqiperise ka aderuar:

-Marreshja e Madridit per regjistrimin nderkombetar te markave

-Protokolli i Marreshjes se Madridit.

"{...} nuk rezulton person fizik apo juridik i regjistruar ne Republiken e Shqiperise" pasi nuk ploteson asnje nga kriteret e parashikuara ne ligjin 9723/2007 "Per regjistrimin e biznesit". Ky subjekt nuk rezulton te jete regjistruar me numer unik te identifikimit (NUIS), emer te subjektit tregtar, emer te administratorit/ortakut/aksionerit si dhe vendin ku ushtron aktivitetin tregtar. I padituri nuk disponon asnje te dhene apo dokument qe te vertetoje se "{...}' te kete regjistruar dege te nje shoqerie te huaj me kete emer ne regjistrin tregtar apo te jete aksioner/ortak aktual i ndonje shoqerie tregtare te regjistruar ne regjistrin tregtar . Referuar te gjithe procesit gjyqesor dhe dokumentacionit ligjor te sjelle nuk rezulton e provuar se pala e trete "{...}" e cila eshte ne rolin e markes kundershguese te kete provuar te kete interesat e ligjshem ne kete geshtje. Bazuar ne nenin 174 te ligjit 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale" marka nderkombetare IR1030845 "{...}" (fjale e figure) eshte marke e zhvleftesuar ne territorin e Republike se Shqiperise. Nese do ti referohemi te dhenave te paraqitura nga vete i padituri rezulton se kundershguesi ka regjistruar me date 14.10.2009 nderkombetare IR1030845

"{...}" (fjale e figure) ne klasat 03,12,16,18,20,22,24,25,28,41,42 sipas klasifikimit nderkombetar te Nices. Sig dhe kemi prapesuar prane DPPI (pika III e faqes 2 te vendimit) te Bordit te Apelimit) marka kundershuese eshte marke e zhvlefesuar ne territorin e Republikes e Shqiperise sepse nuk i ka perdorur mallrat ose sherbimet per te cilat eshte regjistruar ne asnje rast qe prej 14.10.2009, pra prej 9 vitesh. Autorizimi i leshuar nga subjekti "{...}", ne emer te Av. {...} per te depozituar prane DPPI kundershimet e regjistrimit te markes "{...}" me nr. Aplikimi AL/T 2016/833 eshte i pavlefshem dhe si i tille ankimi quhet i parealizuar sepse: Autorizimi i perfaqesimit referuar ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe vendimit Nr.1706, date 29.12.2008 "Per miratimin e Rregullores per Regjistrimin e Markave Tregtare dhe te Sherbimit" i ndryshuar eshte i vlefshem vetem kur leshohet nga personat juridik shqiptare gfare do te thote se nese nuk plotesohen kriteret ligjore, perfaqesimi nuk ka fuqi juridike. Autorizimi i leshuar nga Subjekti "{...}", eshte nje dokument i nenshkruar nga nje shoqeri e huaj, per te cilen nuk disponohet asnje e dhene per arsyet e permendura me siper. Referuar autorizimit te leshuar si nga pamja vizuale ashtu dhe nga ana ligjore nuk mund te vertetohet se kush eshte personi qe e ka nenshkruar, ka patur tager per ta leshuar nje dokument te tille dhe gfare marredheniesh ekzistojne ndermjet Subjektit "{...}" dhe perfaqesuesit te tij Av. {...}t? 3.Sipas Ligjit 9060, date 08.05.2003 "Per aderimin e Republikes e se Shqiperise ne "Konventen per Heqjen e Kerkeses per Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare te Huaja", gdo dokument zyrtar i nje shteti te huaj anetar i kesaj Konvente, qe perdoret ne institucionet e Republikes se Shqiperise nuk legalizohet nga perfaqesite diplomatike dhe konsullore por pajiset me vulen Apostille nga autoriteti kompetent i vendit , i cili e ka leshuar dokumentin duke e bere ate njesoj te vlefshem si brenda vendit ashtu dhe ne Republikën e Shqiperise. Ne rast se dokumenti leshohet nga nje vend jo anetar i Konventes, legalizimi i dokumentave zyrtare per perdorim ne Republikën e Shqiperise behet sipas VKM nr. 134, date 07.03.2003.

Referuar Autorizimit te leshuar nga subjekti i huaj "{...}", ne emer te Av. {...}, mungon vula Apostille si nje element shume i rendesishem per legjitimimin e ketij dokumenti per perdorim ne institucionet e Republikes se Shqiperise, perfshire dhe te paditurin DPPI, duke e bere ate te pavlefshem.

4.Per sa i perket perkthimeve zyrtare, gdo dokument perdorim ne Republikën e Shqiperise qe te kete fuqi ligjore dhe te jete i kuptueshem nga institucionet , perveg vules Apostille, duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe nga nje perkthyes i licensuar dhe i autorizuar nga Ministria e Drejtesise, autenticiteti i firmes e te cilit duhet te vertetohet nga noter publik, fakt ky qe nuk ekziston ne autorizimin e "{...}" Referuar parashikimeve te ligjit 7829, date 01.06.1994 "Per noterine" i ndryshuar dhe udhezimit nr. 3165, date 15.04.2004 rezulton e provuar se Av. {...} nuk ka tager per te kerkuar kundershimin e regjistrimit te markes "COOL {...}" me nr. Aplikimi AL/T2016/827 prane DPPI, pasi autorizimi me te cilin eshte pajisur nga "{...}", nuk ploteson asnje kriter ligjor, gka do te thote se vendimi nr. 827/11 date 25.10.2017 i Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te

Pronesise Industriale, eshte nxjerre ne shkelje te rende procedurale, sepse nuk mund te konsiderohet i ligjshem nje Vendim, kur dokumenti te cilit i eshte referuar Bordi i Apelimit per nxjerrjen e tij eshte absolutist i pavlefshem.

Bazuar ne keto argumenta, perfaqesuesja e pales paditese kerkoj pranimin e kerkese padise sipas objektit.

Gjate gjykimit perfaqesuesi i pales se paditur parashitroi keto prapesime:

Kundershtuesi e ka paraqitur kerkesen per kundershitim ne perputhje me parashikimet e shkronjes "a", te pikes 1 te nenit 152, si dhe shkronjave b e c te pikes 2, te nenit 143 te ligjit nr. 9947 date 07.07.2008 (i ndryshuar). Bordi konstaton se kundershuesi legjitimohet per te paraqitur kerkesen per kundershitim pasi gezon nje te drejte te meparshme, te cilen e ka fituar nepermjet regjistrimit te markes kundershuese, perpara dates se depozitimit te kerkeses per regjistrimin e markes qe kundershohet; pra marka kundershuese gezon statusin e markes se meparshme ne kuptim shkronjes a te, pikes 5, te nenit 143 te Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008. Gjithashtu, konstatohet

se ky kundërshtim është depozituar brenda afatit të parashikuar nga pika 4 e nenit 175 dhe pikës 1 të nenit 152 të ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 (i ndryshuar).

Kundërshtuesi ka mbështetur kërkesat e tij në shkronjën b, të pikës 2, të nenit 143, të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 (i ndryshuar). Kjo dispozitë parashikon kushtet ligjore që duhen të ekzistojnë për kundërshtimin e një aplikimi (për markë),

• *Ngjashmeria* ndërmjet *markave*.

Markat krahasohen në tri aspekte të tyre, vizuale, fonetike, konceptuale.

Për të bërë një analizë të saktë të ngjashmerisë ndërmjet markës së kundërshtuar dhe asaj të pretenduar nga kundërshtuesi, duhet të merret në konsideratë teresia e elementeve përberëse të tyre dhe pershtypja e përgjithshme që shkaktojnë ato tek konsumatori, por duke u fokusuar më tepër në elementet dominante që mbartin edhe karakterin dallues të markave në shqyrtim.

*Ngjashmeria vizuale:*

Mund të themi për sa i përket markës së kundërshtuar, se elementi verbal i saj është i shkruar me shkronja shtypi, ku bie më tepër në sy elementi {...}, për shkak të permasave me të mëdha në teresinë e markës. Gjithashtu, elementi verbal me i dukshëm {...} - i markës së kundërshtuar rezulton të jetë shumë i ngjashëm me atë {...} të markës kundërshtuese, pikërisht për shkak se fjalet {...} dhe {...}(S), janë në aspektin pamor pothuaj identike.

Konstatohet se tek të dyja markat elementet grafike rezultojnë relativisht të ngjashme, sepse konsistojnë në figura gjeometrike të ngjashme, me kënde të rrumbullakosura, të cilave iu janë brendashkruar emertimet e secilës shenje. Pra, nga analiza e mesiperme, në aspektin pamor, konstatohet njëfarë ngjashmerie vizive ndërmjet shenjave në diskutim.

Është për t'u theksuar fakti që pavarësisht ndryshimeve pamore që ekzistojnë ndërmjet markave, duhet mbajtur parasysh që konsumatori priret të memorizojë më tepër elementet e përbashkëta sesa diferencat, sidomos kur emertimet e markave janë tepër të ngjashme, si ndodh në rastin tone, pasi emertimet rezultojnë praktikisht me identifikuesë për markën, d.m.th. mbajnë peshën kryesore të karakterit dallues të një marke.

*Ngjashmeria fonetike:* Sikurse përmendëm më lart, elementet verbale të markave në diskutim, të cilat do t'i nënshtrohen analizës fonetike, janë : "{...}" vs "{...}" .

Markat kanë ngjashmëri të lartë fonetike, sepse ato përmbajnë një element të njëjtit "{...}". Fjalet {...} dhe {...}, vlerësojmë se shqiptohen në një mënyrë pothuajse identike, pasi zakonisht bashkëtingellorja "S" në fund të fjales, në të folurën me shpejtësi normale, shumë shpesh kur takohet me tingullin "T", nuk degjohet si e pavarur nga "T", por zbut tingëllimin e saj. **Ngjashmeria konceptuale:** Analiza e ngjashmerisë konceptuale do të marrë në konsideratë vlerësimin e aspektit kuptimor të secilës marke, si dhe shqyrtimin mundësisë së konfuzionit në publik, që një ngjashmëri eventuale në këtë aspekt mund të shkaktojë.

Bordi i Apelit i DPPI, konstaton se elemente dominante të markave janë ato verbale, jo vetëm për shkak të pozicionit qendror dhe permasave të konsiderueshme në teresinë e markave respektive, por edhe sepse në rastin e markave fjale dhe figure, përgjithësisht elementi fjale luan rolin me të rëndësishëm në teresinë e markës, sepse në përgjithësi konsumatori e identifikon markën! më tepër nëpërmjet emertimit të saj sesa prej elementeve figurative.

Në shqyrtimin konkret, konstatohet gjithashtu se elementet grafike nuk kanë kuptim konkret, ose nuk i referohen një figure që në perceptimin e publikut asociohet me një objekt ose një koncept konkret, por vegjëse kanë si qëllim të evidentojnë elementet verbale të markave, për t'u dhënë atyre më shumë forcë dalluese.

Bordi konstaton se kemi në analizë elementet verbale: "{...}" vs "TATGETS", që në shqip (për njohësit e anglishtes) kanë përkatësisht kuptimin: Objektiv vs Objektiva.

Konstatohet për më tepër, që në emertimin e markës së kundërshtuar, është e inkorporuar marka kundërshtuese.

Sikurse rezulton nga doktrina por edhe nga praktika tashme e zakonshme në treg, shoqëritë tregtare krijojnë dhe përdorin rëndom shenja dalluese me emertime dhe elemente të tjera të ngjashme për mallra dhe/ose shërbime të njëjta ose të ngjashme, që njihen në teori si marka të së njëjtes familje, për të rinovuar imazhin e tyre, për identifikimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të reja që hedhin në treg, apo për arsye të tjera marketingu. Analiza e mesiperme i referohet publikut njohës të anglishtes. Për pjesën tjetër të publikut, themi që ai e formon konceptin e përgjithshëm mbi markat në bazë të sinjaleve që marr nga perceptimi i krijuar nëpërmjet shqisave të të parit dhe të degjuarit. Nga pikepamja e këtij perceptimi, d.m.th. vizual dhe fonetik, Bordi i vlerësoi më lart markat shumë të ngjashme për konsumatorin. Pra, sa thame më sipër përforcojnë bindjen tone se të dyja markat përcjellin kuptime tepër të ngjashme tek konsumatori shqiptar.

**Ngjashmeria mes mallrave:** Bordi vëren se markat në diskutim mbulojnë mallra të së njëjtes klase (klases 16 të klasifikimit të Nises).

Mallrat në diskutim me se shumti koincidojnë në terma, përfshirë sinonimet e tyre. Për sa i përket pjesës tjetër të mallrave, ato dukshëm përfshihen tek kategoria e njera-tjetres. Përfundimet e mesiperme, ku; shërbimet u vlerësuan identike apo shumë të ngjashme; markat u vlerësuan i shumë të ngjashme në pdo aspekt;

themë se i plotësojnë plotësisht kriteret e pikës 2 "b" të nenit 143, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 (i ndryshuar)

Në këto kushte, për arsye të mallrave të njëjta dhe të ngjashme, për shkak të ngjashmerisë ndërmjet markave në atë masë që shkakton konfuzion tek përdoruesi, vlerësojmë se është tepër e lartë mundësia që konsumatori t'i bashkëlidhë mallrat e ofruara nga dy subjektet d.m.th të mëndoje se mallrat me shenjen që kundërshtohet janë ofruar në treg nga i njëjti subjekt tregtar që ofron në treg mallrat me shenjen e mëparshme kundërshtuese.

Përfundimisht, Bordi i Apelit i DPPI arrin në konkluzionin se aplikimi për regjistrimin e markës së kundërshtuar "{...}" cenon të drejtat e mëparshme të markës së mëparshme kundërshtuese, në kuptim të shkronjave "b" dhe "c", të pikës 2, të nenit 143, të Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 (i ndryshuar).

Gjykata duke pasur parasysh pretendimet dhe prapesimet e paleve, provat e paraqitura prej tyre, si dhe parashikimet ligjore, gmon se kerkimet e paditesit jane te bazuara. Ne vijim po parashtrojme argumentat: Se *pari*, pretendimi i paditesit se akti objekt gjykimi eshte akt absolutisht i pavlefshem eshte i bazuar. Neni 108 i Kodit te Procedurave Administrative "Akti administrativ absolutisht i pavlefshem" parashikon: "Akti administrativ eshte absolutisht i pavlefshem ne rastet e meposhtme:

a) kur vjen ne kundersiztim te hapur dhe flagrant me nje dispozite urdheruese te ketij Kodi dhe legjislacionit ne fuqi lidhur me:

i) kompetencen e organit publik;

ii) proceduren e nxjerrjes se tij; ose

iii) formen ose elemente te tjere te detyrueshem te aktit;

b) eshte nxjerre nepermjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit te interesit, falsifikimit apo nje veprimi tjetër qe perben veper penale;

c) ekzekutimi i aktit mund te shkaktoje nje veprim te denueshem, sipas legjislacionit penal;

g) ne gdo rast tjetër te parashikuar shprehimisht ne ligj"

Neni 143 i ligjit nr. 9947/2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar "Refuzimipershkaqe relative" parashikon: "1. Marka nuk mund te mbrohet nese perdorimi i saj bie ne kundersiztim me te drejtat e meparshme.

2. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur:

a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme;

b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;

c) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, edhe kur eshte per t'u regjistruar ose eshte regjistruar per mallra apo sherbime, qe nuk jane te ngjashme me ato, per te cilat eshte regjistruar marka e meparshme, kur marka e meparshme ka nje reputacion ne Republikën e Shqiperise dhe perdorimi ose regjistrimi i markes ne fjale, pa shkak te arsyeshem, fiton prioritet te padrejte ose demton natyren dalluese apo emrin e mire te markes se meparshme.

3. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nese cenon te drejtat e meparshme, te fituara, si:

a) te drejten e emrit tregtar, me kusht qe ky emer ose pjesa thelbesore e tij te jete e njejte apo e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet, dhe qe pronari i emrit tregtar te prodhoje apo te siguroje perkatesisht mallra ose sherbime, te njejta ose te ngjashme me ato te markes, qe kerkohet te regjistrohet;

b) te drejten e nje personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e te cilit eshte e njejte ose e ngjashme me marken, qe kerkohet te regjistrohet;

c) te drejtat e pronesise industriale, perfshire emrat e varieteteve te mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe te treguesve gjeografike;

**g) te drejtat e autorit te nje vepre ose te nje pjese te saj, me kusht qe ajo te jete e njejte ose e ngjashme me marken, qe kerkohet te mbrohet.**

4. Marka nuk mbrohet, nese eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te regjistruar, per mallra apo sherbime te njejta ose te ngjashme dhe nese vlefshmeria e saj ka mbaruar per shkak te mbarimit te afatit te mbrojtjes, per nje periudhe gjashtemujore nga mbarimi i ketij afati.

5. Marke e meparshme, ne kuptim te pikes 2 te ketij neni, vleresohet:

a) marka, me nje, date aplikimi per regjistrim me te hershme sesa data e aplikimit per regjistrim e nje marke tjeter tregtare, duke pasur parasysh, kur eshte rasti, pretendimin per prioritet per ate marke, sipas nenit 147 te ketij ligji;

b) marka, qe eshte regjistruar me pare, nepermjet nje marreveshjeje nderkombetare, ne te cilen Republika e Shqiperise eshte pale;

c) aplikimi per nje marke, sipas percaktimit te shkronjave "a" e "b" te kesaj pike, ne varesi te regjistrimit te tyre;

g) marka, e cila, ne, daten e aplikimit per regjistrim, ose ne, daten e prioritetit, ne rastet kur pretendohet per prioritet, eshte e mirenjohur ne Republiken e Shqiperise, ne kuptim te nenit 6 bis te Konventes se Parisit, te publiku i sektorit perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimit ose reklamimit, ne perputhje me parashikimet e DPPM-se dhe te

Neni 152/1 germa "a" i ligjit nr. 9947/2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar parashikon :

1. "Kundershtimi ndaj nje marke te publikuar depozitohet ne DPPM brenda nje periudhe tremujore nga data e publikimit, kundrejt pageses se tarifes perkatese.

a) aplikanti i nje marke te meparshme te depozituar ne DPPM ose nga Pronari i nje marke te meparshme, regjistruar ne perputhje me parashikimet e pikave 1 e 2 te nenit 143 te ketij ligji.

Ne Kreun VI te VKM nr. 1706" date 29.12.2008 "Per miratimin e rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit " parashikohet:

1. Paraqitja e kundershimit:

1.1 Kundershtimi ndaj nje marke te publikuar mund te paraqitet prane DPPM Brenda tre muajve nga data e publikimit nga personat e parashikuar nga neni 152 I ligjit ndermjet depozitimit te dokumentave te meposhte:

a) formulari FM9 per kundershimin e regjistrimit te markes

b) dokumentin e pageses se tarifes per kundershimin.

1.2 Kundershtuesi duhet te paraqese edhe dokumentet e meposhtme:

a) autorizimin e perfaqesimit, ne rast se kundershtimi paraqitet nga perfaqesuesi i kundershhtuesit;

b) dokumentet qe provojne, se kundershhtuesi gezon nje nga te drejtat e parashikuara nga neni 143 i ligjit

2. Shqyrtimi i kundershimit nga Bordi i Apelimit

2.1 Bordi i apelimit shqyrton kundershimin, brenda nje periudhe tremujore, nga data e paraqitjes se te gjitha argumenteve, materialeve dhe dokumenteve shtese nga palet, dhe i njofton ato per vendimin e marre.

2.2 Ne rast se kundershtimi nuk ploteson kerkesat e parashikuara nga pika 1.1 e ketij kreu, Bordi i Apelimit e konsideron te paparaqitur kundershimin dhe njofton me shkrim kundershhtuesin.

2.3 Ne rast se kundershtimi nuk ploteson kerkesat e pikes 1.2 te ketij kreu Bordi i Apelimit i kerkon kundershhtuesit nepermjet nje njoftimi me shkrim te plotesoje te metat brenda 30 diteve nga data e njoftimit, ne te kundert kundershtimi quhet si i paparaqitur.

2.4 Kur kundershtimi i ploteson te gjitha kerkesat e pikes 1 te ketij kreu, Bordi i Apelimit pranon per shqyrtim kundershimin dhe njofton me shkrim aplikantin e markes kunder se ciles eshte depozituar kundershtimi, duke i kerkuar atij qe brenda 1 muaji nga data e njoftimit, te depozitoje me shkrim pretendimet e tij lidhur me kundershimin dhe gdo dokument tjeter ne mbeshtetje te pretendimeve te tij

Ne nenin 64 te Kodit Civil parashikohet se me perfaqesimin nje person ( perfaqesuesi) kryen brenda tagrave qe i jane dhene nga ligji nga prokura ose nga gjykata veprime juridike ne emer dhe per llogari te nje personi fizik ose juridik tjeter (i perfaqesuari).

Ne nenin 65 te Kodit Civil parashikohet se tagrat e perfaqesimit ligjor caktohen nga ligji qe i japin kete cilesi ndersa tagrat e perfaqesuesit te emeruar nga I perfaqesuari caktohen ne prokure. Tagrat e

*perfaqesimit mund te nxirren edhe nga rrethanat ne te cilat kryhen veprimet juridike perkatese,.*

Ne nenin 78 te Kodit Civil parashikohet se: *“Kur nje person fizik ose juridik vepron si perfaqesues, pa e patur kete cilesi si dhe kur perfaqesuesi ka kapercyer tagrat qe I jane dhene veprimi juridik i kryer ne keto kushte nuk eshte i detyrueshem per personin ne emrin e te cilit jane kryer, perveg kur ky e ka miratuar ate me vone”.*

Ne nenin 3 te ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative “ parashikohet : *“Ne kete kod termat e meposhtem kane keto kuptime:*

*“Pale” eshte:*

*a) gdo person fizik ose juridik, i cili ka te drejte ose interes legjitim te drejtperdrejte ne nje procedure administrative, sig percaktohet ne nenin 33, pika 1, te ketij Kodi; ose*

*b) nje pale qe nuk ka nje te drejte ose interes legjitim te drejtperdrejte ne nje procedure administrative, sig percaktohet ne nenin 33, pikat 2 dhe 3, te ketij Kodi, por qe te drejtat ose interesat e saj ligjshem mund te cenohen nga rezultati i procedures”.*

Ne nenin 33 te Kodit te Procedurave Administrative parashikohet: *“ Pale ne proceduren administrative , perveg sa parashikohet ne nenin 3, te ketij Kodi, eshte gdo person:*

*a) me kerkese te te cilit ka filluar procedura administrative*

*b) ndaj te cilit ka filluar procedura administrative , ose te cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedures administrative; ose*

*c) me te cilin organi publik synon te lidhe apo ka lidhur nje kontrate administrative.*

Ne nenin 35 te Kodit te Procedurave Administrative parashikohet:

*“Perfaqesimi i pales*

*1. Pala mund t'i kryeje te gjitha veprimet procedurale personalisht ose nepermjet perfaqesuesit, ne perputhje me parashikimet e ketij Kodi.*

*2. Ne rastin kur pala vepron e perfaqesuar, organi publik kryen veprimet procedurale me perfaqesuesin.*

*3. Organi publik mund te kerkoje kryerjen e nje ose disa veprimeve procedurale drejtperdrejt nga pala, ne rastet kur parashikohet shprehimisht nga ligji. Ne kete rast, organi publik njofton edhe perfaqesuesin”.*

Ne baze te parashikimeve te ligjit te posagem nr. 9947, date 07.07.2008 “Per pronesine industriale” i ndryshuar te drejten per kundershimin e nje marke e ka aplikanti i nje marke te meparshme te depozituar ne Drejtorine e Pergjithshme te Pronesise Industriale ose pronari i nje marke te meparshme, regjistruar ne perputhje me parashikimet e pikave 1 e 2 te nenit 143 te ketij ligji. Ne baze te VKM nr. 1706, date 29.12.2008 “Per miratimin e rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit “ parashikohet se kundershuesi duhet te paraqese edhe dokumentet e meposhtme: a) autorizimin e perfaqesimit, ne rast se kundershimi paraqitet nga perfaqesuesi i kundershuesit.

Pra, se me siper formulari FM9 per kundershimin e nje marke tregtare duhet te paraqitet nga aplikanti i nje marke te depozituar ne Drejtorine e Pergjithshme te Pronesise Industriale dhe, ne rast se ky kundershim paraqitet nga perfaqesuesi i tij, se bashku me formularin FM9 te kundershimit te markes duhet te paraqitet edhe akti i perfaqesimit. Rezulton se Formulari FM9 i kundershimit te markes “{...}”, me numer aplikimi AL/T/2016/833, eshte paraqitur dhe nenshkuar ne emer te personit te trete shoqerise “{...}” me date 15.03.2017 nga z. {...}, ne baze te aktit te perfaqesimit autorizimit, date 13.02.2017. Nga njohja me te dhenat e ketij autorizimi per sa i perket formes rezulton qe ai eshte hartuar ne gjuhe angleze dhe permban brenda te nejtit format dhe perkthimin ne gjuhen shqipe. Nga permbajtja e pjeses se perkthyer nuk jepen te dhena ne lidhje me shoqerine ne emer te te ciles eshte leshuar autorizimi, personin qe ka leshuar kete autorizim, cilesine



e tij prane shoqerise kundershuese. Po keshtu, nuk jepen te dhena se perpara cilit autoritet eshte redaktuar dhe perkthyer ne gjuhen shqipe ky autorizim, rrjedhimisht dhe per vertetesine e nenshkrimet te personit qe e ka nenshkruar ate. Bashkelidhur autorizimit nuk rezulton te jete paraqitur ndonje dokument ne lidhje personalitetin juridik te shoqerise kundershuese( ekstrakt nga regjistri tregetar qe verteton se ajo eshte shoqeri e regjistruar dhe kishte status aktiv ne momentin e leshimit te aktit te perfaqesimit), te drejttat e fituara dhe qe kerkon te mbroje nepermjet kundershtimit. Ne nje suate te tille pala e paditur, ne kundershtim me parashikimet e Kreut VI te VKM nr. 1706, date 29.12.2008 “Per miratimin e rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit” nuk i ka lene kohe perfaqesuesit te rregullonte aktin e perfaqesimit, por ka vijuar proceduren ne shkelje te rregullave per perfaqesimin, te parashikuara nga ligji i posagem dhe ai i pergjithshem sig eshte Kodi Civil dhe Kodi i Procedures Administrative sipercituar mbi perfaqesimin. Sa me siper, gjykata gmon se procedura administrative nga pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale per kundershtimin e markes “{...}” ka filluar pa pasur nje kundershues ne kuptim te nenit 152 te ligjit nr 9947/2008 “Per pronesine industriale “ i ndryshuar dhe VKM nr.1706 date “Per miratimin e rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit” pasi nuk rezulton qe ky kundershim te jete paraqitur nga kundershuesi ne perputhje me keto dispozita, gka perben nje shkelje thelbesore te procedures se parashikuar nga ligji i posagem dhe per rrjedhoje vendimi objekt shqyrtimi gjyqesor eshte nje akt absolutisht i pavlefshem dhe qe duhet te konstatohet si i tille nga gjykata. Kerkese padia per kete pjese eshte e bazuar dhe duhet pranuar.

*Se dyti*, dhe ne vijim te arsytimit sipercituar, per sa kohe qe akti objekt gjykimi eshte absolutisht i pavlefshem ai eshte nul, quhet sikur nuk ka qene, nuk ka sjelle dhe nuk sjelle pasoja. Rrjedhimisht pala e paditur duhet te detyrohet te vijoje procedurat per regjistrimin e markes “{...}” me nr. aplikimi AL/T/2016/833 ne emer te shoqerise paditese.

*Se treti*, per sa u perket shpenzimeve gjyqesore dhe atyre per venien ne ekzekutim te ketij vendimi, bazuar ne nenin 106 te K.Pr.Civile, ato duhet t'i ngarkohen pales se paditur. Keto shpenzime perbehen nga shpenzimet e verifikuara, te renditura ne fund te ketij vendimi.

*Se katerti*, per sa i perket menyres se ekzekutimit te vendimit, bazuar ne parashikimet e neneve 41 dhe 65 te ligjit nr. 49/2012 “Per Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative” i ndryshuar dhe nenit 510/a te K.Pr.Civile, ky vendim, pasi te marre forme te prere, perben titull ekzekutiv dhe duhet te ekzekutohet menjehere nga permbarimi gjyqesor, me kerkese te kreditorit dhe ne rast mosekzekutimi ne menyre vullnetare nga pala e paditur.

Ne perfundim, duke pasur parasysh gjithe sa me siper u citua, gjykata gmon se kerkese padia e paditesit shoqerise “{...}” sh.p.k eshte e bazuar ne prova e ligj dhe si e tille duhet pranuar.

Per keto arsye

Baza Ligjore:

Bazuar ne nenet 40, 41 dhe 46 te ligjit nr. 49/ 2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, i ndryshuar,

VENDOSI:

## Vendosi:

- Pranimin e kerkese padise se paditesit shoqerise "{...}" sh.p.k .
- Konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ vendimit nr. 833/11 Prot, date 25.10.2017 te Bordit te Apelimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale.
- Detyrimin e pales se paditur Drejtorise se Pergjithshme e Pronesise Industriale te vijoje procedurat per regjistrimin e markes "{...}" me nr. aplikimi AL/T/2016/833.
- Shpenzimet gjyqesore dhe ato per venien ne ekzekutim ne ngarkim te pales se paditur.
- Ky vendim perben titull ekzekutiv, pasi te marre forme te prere dhe duhet te ekzekutohet menjehere nga permbarimi gjyqesor.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane, brenda 15 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.

•Vendimi t'u komunikohet paleve.

•U shpall sot, ne Tirane, me 17.03.2021

## SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:  
{...}